

VENDIM
Nr. 783, datë 15.12.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, NYJA TEG”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Ndërtimi i segmentit rrugor, nyja TEG”.
 2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, për pasuritë e llojit “tokë arë” “truall” dhe “ndërtesë”, me vlerë të përgjithshme prej 64 499 504 (gjashtëdhjetë e katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katër) lekësh.
 4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 64 499 504 (gjashtëdhjetë e katër milionë e katërqind e nëntëdhjetë e nëntë mijë e pesëqind e katër) lekësh, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 6. Shpronësimi i pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
 7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 8. Autoriteti Rrugor Shqiptar kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
 9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
 10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe bën kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
 11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin kur do të realizohet procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit.
 12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Tiranë Rurale 1, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Arben Ahmetaj

LISTA E PRONARËVE, TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË SHPRONËSOHEN NGA REALIZIMI I PROJEKTTIT “NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR, NYJA TEG”

Nr .	PRONARI	ZK	Nr. i pas.	Lloji i pasurisë	Sip. totale	VLERËSIMET												VLERA TOTAL E (LEKË)	Shënime
	Emri i pronarit					Sip. shprons . (m²)	TOKE ARË			TOKE TRUALL			OBJEKT SOC.-EK.		OBJEKT BANIMI				
							Sip. e shpron .	Vler a	Total	Sip e shpron .	Vler a	Total	Sip e shpron .	Total	Sip e shpron .	Vlera	Total		
1	Kadri Hasan Husha	270 4	533/4	Arë + truall	825	825	325	523	169,975	500	3,283	1,641,500	315	15,759,302	73	66,500	4,867,800	22,438,577	Konfirmim ASHK
2	Albsina Group	252 9	574/3	Arë	2,400	206	206	523	107,738									107,738	Konfirmim ASHK
3	Avni Doda	252 9	583/13	Arë	5,372	1,050	1,050	523	549,150									549,150	Konfirmim ASHK
4	Pajtim Struga	252 9	583/14	Arë + truall	4,000	365	365	523	190,895									190,895	Konfirmim ASHK
5	Pullumb Tahir Krraba Ismet Islam Krraba	252 9	583/28	Truall + ndërtesë	4,116	486				486	3,283	1,595,538	1,100	38052267				39,647,805	Konfirmim ASHK
6	Renalda Refit Korbeci	252 9	583/17	Pemëtore	4,000	2,680	2,680	523	1,401,640									1,401,640	Konfirmim ASHK
7	Jonald Ali Agolli	270 4	547/76	Ullishte	1,875	129	129	523	67,467									67,467	Konfirmim ASHK
8	Luan Pelivan Betaj	270 4	547/66	Ullishte	2,795	57	57	523	29,811									29,811	Konfirmim ASHK
9	Jonald Ali Agolli	270 4	547/77	Ullishte	2,250	127	127	523	66,421									66,421	Konfirmim ASHK
VLERA TOTALE E SHPRONËSIMIT																		64,499,504	